



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Infinit" Sh.P.K. të datës 04.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje teknologjike - Tableta" me nr. të prokurimit 616-23-10138-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Infinit" Sh.P.K. e datës 04.12.2023 kundër kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje teknologjike - Tableta" me nr. të prokurimit 616-23-10138-1-2-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 29.11.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Infinit" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Infinit" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 04.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje teknologjike - Tableta" me nr. të prokurimit 616-23-10138-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë formuluar si në vijim:

Pretendimi i parë – “OE i rekomanduar per kontrate nga AK nuk ka dorezuar deklaraten per specifkimet teknike si ne kerkesen ne nenin 3.1 te FDT”.

Pretendimi i dytë – “OE i rekomanduar per kontrate nga AK poashtu eshte i papergjegjshem pasiqe nuk ploteson kriterin nr.1 lidhur me kapacitetin teknik&profesional. Kerkese e AK ka qene te dorezohen deshmi certifikata te pranimit apo referencat dhe nga shkresat e lendes shihet se AK ka kerkuar sqarime shtese nga OE i rekomanduar per kontrate i cili nuk ka dorezuar deshmi (certifikatat e pranimit apo referencat) por deshmite e pagesave per furnizimet e realizuara me OE privat qe nuk eshte ekuivalente me kerkesen e AK”.

Lidhur me pretendimin e parë të parashtruesit nga dokumentet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar nuk është arritur të evidentohet se është dorëzuar deklarata për specifkimet teknike sikurse është kërkuar me pikën 3.1 të FDT. Në anën tjetër nuk është kontestuese që ky dokument është kërkuar përmes pikës 3.1 të dosjes së tenderit. Me rastin e rivlerësimit komisioni vlerësues duhet të verifikoj nëse është dorëzuar ky dokument nga tenderuesi i rekomanduar në përputhje me dosjen e tenderit. Në këtë kuptim pretendimi i parashtruesit është pretendim i bazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë të parashtruesit fillimisht duhet cekur se kërkesa për të cilën bëhet fjalë në dosjen e tenderit është formuluar si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, ne vlere minimale prej 20.000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve
---	-----------	---	---

Nga oferta e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se është plotësuar lista e kontratave sipas aneksit 6 të dosjes së tenderit mirëpo nuk janë bashkëngjitur referencat ose certifikatat për kryerje të punëve. Për këtë arsye autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar i cili së bashku me përgjigjen e vet ka bashkëngjitur edhe disa fatura dhe transaksione bankare. Me këtë rast duhet cekur se të gjitha kontratat e prezantuara nga tenderuesi i rekomanduar janë kontrata me operatorët ekonomik privat. Megjithatë komisioni vlerësues duhet të verifikoj dhe të vendos nëse këto fatura janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit. Sidoqoftë është fakt i pakontestueshëm se tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar asnjë referencë apo certifikatë për kryerje të punimeve sikurse që është kërkuar me dosjen e tenderit. Prandaj ky pretendim i parashtruesit është pjesërisht i bazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij Në këtë mënyrë është gjetur se komisioni vlerësues nuk pra vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP dhe 40 të RRPP. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 12.12.2023


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.